

VENDIM
Nr.620, datë 8.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1092, DATË 2.7.2008 “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË DOGANAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1092, datë 2.7.2008, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura e pagave të sistemit doganor”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e doganave”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1, është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2010.

3. Ngarkohet Minisria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË DOGANAVE

PAGA MUJORE							
	Pozicioni		Paga individuale			Shtesa e pozicionit	
Klasifikimi doganor		Kategoria	Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
	Titullar i institucionit	II-a	1	2%	0	105 000	20 000
	Zv/drejtor i përgjithshëm	II-b	1	2%	0	88 000	15 000
A	Këshilltar. Drejtor drejtorie. Drejtor drejtorie rajonale. Kryetar i degës doganore Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë	III-a	1	2%	0	71 000	15 000
	Përgjegjës/shef sektori. Kryetar dege doganore Fier, kapshticë, Korçë, Lezhë, Bllatë, Kukës,						

B	Sarandë, Berat, Tri Urat, Qafë-Thanë, Elbasan. Përgjegjës operacionesh doganore në degën doganore Tiranë, Durrës.	III-a/1	1	2%	0	62 000	14 000
C1	Inspektor kontrolli i brendshëm. Përgjegjës turni. Përgjegjës zyre. Komandant grupi antikontrabandë. Specialist laborator. Specialist, jurist, administrator rrjeti.	III-b	1 ose 2	2%	0	54 000	14 000
	Financier në degë doganore, Përkthyes, Koordinator në DOH, Specialist i imarrëdhënieve ndërkombëtare.	III-b	1 ose 2	2%	0	54 000	12 000
C2	Doganier kontrolli dokumentar fizik. Inspektor antikontrabande. Asistent laborator. Llogarotar.	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	0	43 000	12 000
C3	Doganier pranues. Doganier peshoreje. Doganier pike kontrolli. Përpunues informacioni. Sekretare. Arkivist.			1%		35 000	7 000
D1	Magaziniar. Furnitor. Operator. Shofer. Teknik.			1%		30 000	3 500
D2	Punëtor mirëmbajtës			1%		20 600	3 000
D3	Punonjës pastrimi			1%		19 000	

Lidhja nr.3

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë